

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 1
12.07.2010

NR. VENDIMI 1
09.03.2011

V E N D I M

“MBI KONFISKIMIN E PASURIVE”

Gjykata e Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane e perbere prej gjyqtareve:

K / Seance : DRITAN HALLUNAJ
Anëtare : ETLEVA DEDA
Anëtar : SANDER SIMONI

me sekretare gjyqesore **Ankela Dake**, mori ne shqyrtim sot me **dt.09.03.2011** ne seance gjyqesore publike kerkesen penale nr. 1 / 13 Akti, qe i perket :

KERKUES: Prokuroria Per krime te Renda Tirane , perfaqesuar ne gjykim nga prokuroret **B.M** dhe **A.Xh.**

OBJEKTI: **Konfiskimin e pasurive se te ndjerit**
K. (K) S.

PERSONA TE TRETE: **1.A.S**, i biri i N dhe I N,
i dtl xx/xx/xxxx, banues ne Lagja Nr.xx,
Rr.”x.xxxx”, Pallati xxx –
xxxxx,perfaqesuar ne gjykim nga av. S. V.

2.H.S , e bija e Xh dhe e H dtl.
xx.xx.xxxx banues ne Lagja Nr.15,
Rr.”x.xxxx”, Pallati xxx – xxxxxx,te
perfaqesuar ne gjykim nga **A.S** me
prokuren e posacme nr.xxxx Rep,xxx
Kol date xx.xx.xxxx.

BAZA LIGJORE:

**Ligji nr. 10192 datë 03.12.2009 “Per
parandalimin dhe Goditjen e Krimit te
Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet
Masave Parandaluese kundër Pasurisë”,**

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen ne teresi degjoi perfaqesuesin e organit
te akuzes qe kerkoi pranimin e kerkeses dhe konkretisht:

Konfiskimin e pasurive të mëposhtme :

- 1. Prone truall** me sipërfaqe **prej xxxx mx** ndodhur në zonën kadastrale nr. xxxx, Pasuria me nr.x/xx, volumi, x faqja xx, e cila ndodhet në adresën xxxx-xxxxxx, në pronësi të shtetasit **A.N.S**, blerë nga shtetasi H.I.M me kontratën nr. xx rep., xx kol datë 18.01.2005, për shumën 750 000 lekë dhe regjistruar në këtë Zyrë në datën 24.01.2005.
- 2. Pronë truall** me sipërfaqe **xxx mx**, ndodhur në zonën kasatrale nr. xxxx, me nr. Pasurie x/xx, volumi x, faqja xx, me adrese xxxxx-xxxxxx, blerë nga shtetasi H.I.M etj., **me kontratën nr.xxxx rep., xxx kol. datë 26.06.2000 për shumën 800 000 lekë**, dhe regjistruar në këtë Zyrë në datën 27.06.2000, së bashku dhe me një objekt **Bar-Restorant me sip.130 m2, i cili është ndërtuar mbi këtë sipërfaqe toke, sipas lejes së ndërtimit nr. 4, datë 22.06.2001** të K RR T Bashkisë Durrës, të dyja në emër të shtetasit **A.N.S**,
- 3. Autovetures** tip Benz, me targa **xx xxxx x**, me nr.shasie xxxxxxxx xxxxxxxx pronë e shtetasit **A.N.S**, blerë në datë **13.09.2002** nga shtetasi M.B.

4. **Autovetures** tip xxxxxxxx, marka xxxx me targa **xx xxxx x**, prodhim i vitit xxxx, me nr.shasie xxxxxxxxxxxxxxxx, pronë e shtetasit **A. N .S** blerë në datë **05.07.2003**.

2. **Heqjen dorë nga konfiskimi i pasurive të mëposhtëme**, pasi janë krijuar me burime të ligjshme;

a. **Depozitës së kursimit të xxxxxxx xxxx, xxxxxx, me nr.xxxxxxxxxx**, e çelur në datën **01.10.2004**, në emër të shtetasit **A. N. S** në shumën 1 090 245 lekë, dhe me vlerë aktuale **1 226 518** lekë.

b. **Depozitës së kursimit të xxxxxxx xxxx - Durrës, me nr.xxxxxxxxxx**, e çelur në datën **01.10.2003**, në emër të shtetasës **H .Xh .S** në shumën 420 000 lekë, dhe me vlerë aktuale 719 749 lekë.

3. Per Administrimin dhe perdorimin e keryre pasurive te paluajtshme te ngarkohet **zj.E. Ç**, ndersa per pasurite e luajtshme te ngarkohet z. **I.D**, te cilet jane Administratore prane Agjencise per Administrimin e pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara prane Ministrise se Financave Tirane, ndersa per ekzekutimin e ketij vendimi te ngarkohen Zyra e Permbarimit e Rrethit Durrës.,

Degjoi perfaqesuesin e personave te trete qe ne perfundim kerkuan:
Mospranimin e kerkeses se organit te akuzes si te pambeshtetur ne prova.

VEREN SE :

Prokuroria për Krime të Rënda Tirane me date 03.04.2005, ka regjistruar procedimin penal Nr.35, për veprat penale të “Vrasjes me paramendim ne bashkepunim” ne dem te shtetasit K. S, ndodhur me date 26.02.2005, “Mbajtjes pa leje te armeve luftarake me pasoja te renda” dhe “Grup te strukturuar kriminal”, te parashikuara nga nenet 78 – 25, 278/4 dhe 333/a te K. Penal, pasi Prokuroria e Rrethit Gjyqesor – Durres, kishte shpallur moskopetencen lendore.

Gjate hetimeve te metejshme ne kuader te ketij procedimi rezultoi se i pandehuri L. B dhe shtetasi **K. (K) .S** (aktualisht i vrare) qe nga viti 1998 e ne vazhdim kane krijuar dhe drejtuar nje Organizate Kriminale me shtrirje dhe aktivitet ne rrethin e Durresit dhe me gjere, ne te cilen benin pjese te pandehurit P. D, I. T, A. (D)

.C, E. D , si dhe shtetasit I. Xh, A. P, aktualisht te vrare, etj. Më pas për shkak të kontraditave kjo organizatë është ndarë në dy të tilla të drejtuara respektivisht nga i pandehuri L. B dhe tjetra nga K. S. Anëtarët e kësaj Organizate Kriminale ne kuader te veprimtarise se saj kane kryer nje numer te madh veprash penale gjatë viteve 1998 deri 2005. Konkretisht:

- Ne date 17.10.1998 rreth ores 18.30 i pandehuri L. B ne bashkepunim me te pandehurit P .D dhe D. C si dhe shtetasit K. S dhe I. Xh (aktualisht te vrare) kane vrare me arme zjarri shtetasin D. S ne qytetin e Durrresit.

- Ne vijim te goditjeve kriminale ndaj kundershhtareve ne qytetin e Durrresit, i pandehuri L. B ne bashkepunim me te pandehurit P. D, D. (A) .C, dhe shtetasit e vrare K. S e I. Xh kane organizuar dhe vrare me date 29.10.1998, rreth ores 17.00 ne fshatin Rrashbull te Rrethit Durres shtetasit A. P e V. C dhe kane plagusur rende shtetasin M. S.

- Ne date 05.07.1999 i pandehuri L. B ne bashkepunim me te pandehurit P. D, D. (A) C. , I. T, dhe shtetasin K. S, kane vrare me arme zjarri shtetasin E. O.si bashkepunetor te shtetasit M. S. dhe strehues te autoreve qe vrane shoket e tyre I. Xh e A. P.

- Ne date 22.08.1999, rreth ores 21.00 i pandehuri L. B, ne bashkepunim me te pandehurit P. D., I. T, D. (A) .C dhe shtetasin K. S kane vrare shtetasin M. S ne vendin e quajtur zona e Plazhit ne qytetin e Durrresit.

- I pandehuri I. T ne bashkepunim me te pandehurin E. D pas arrestimit te shtetasit K. S ka mare dhe ka mbajtur peng per nje periudhe rreth 18 muaj duke e izoluar ne banesen e tij shtetasen V. J me qellim qe te shmangte deshmine e saj para organeve kompetente dhe si rrjedhim per tui shmangur denimit shtetasi K. S. . Si rrjedhim ata kane konsumuar vepren penale te “ Rrembimit dhe mbajtjes peng te personit”, parashikuar si krim nga neni 109 i K. Penal.

Nga hetimet e kryera për këtë procedim penal eshte provuar veprimtaria kriminale e te pandehurve L. B, E. D etj, si dhe veprimtaria kriminale tashme e te ndjerit K. (K) .S, e cila ka filluar pas **periudhës 17.10.1998** (datë në të cilen ne qytetin e Durrresit, është kryer vrasja me arme zjarri e shtetasit D. u, vrasje e cila eshte kryer nga I

*pandehuri L. B ne bashkepunim me te pandehurit P. D dhe D. C si dhe shtetasit K. S dhe I. Xh (aktualisht te vrare). Aktiviteti kriminal I te ndjerit K. (K) .S ka vijuar **deri në 26/02/2005, date ne te cilen dhe eshte vrare.***

Nga veprimet hetimore ka rezultuar se e gjithë veprimtaria kriminale drejtohej nga interesa personale te personave, te pandehurve L. B etj, si dhe te te ndjerit K. S, kryesisht ne drejtim te eleminimit fizik te kundërshtareve te tyre. Ne te gjitha episodet e lartpermendura rezultojne te ndermarrin veprimtari kriminale te njejtet te pandehur. Nje tjetër element i organizates kriminale eshte edhe kohezgjatja e veprimtarise kriminale qe nga viti 1998 deri ne vitin 2005.

Veprat penale sic theksuam dhe me mesiper jane kryer nga te pandehurit L. B, P. D, I. T, B. G, E. D dhe D. (A) .C, si dhe shtetasit K. S, I. Xh dhe A. P (aktualisht te vrare) etj., ne formen me te larte te bashkepunimit si fillim në kuadrin e një Organizate Kriminale të Drejtuar nga i pandehuri L. B dhe i ndjeri K. S dhe më pas në kuadrin e dy Organizatave Kriminale te mirefillta me drejtues te pandehurin Lulzim Berisha dhe te ndjerin K. (K) S.

Në datën **16.06.2007**, Prokuroria per Krime te Renda- Tiranë, ka dërguar për gjykim procedimin penal nr.35 te vitit 2005, dhe aktualisht kjo çështje është ende në fazën e gjykimin në Gjykatën e Shallës së Parë për Krime të Rënda -Tiranë, ku te pandehurit **L. B, E. D, .. etj**, po gjykohen per veprat penale per te cilat dhe jane akuzuar.

Nisur sa me lart, rezulton se i ndjeri K. S, eshte subjekt i ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 **“Per parandalimin dhe Goditjen e Krimet te Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”**, (neni 3/3). Ndodhur në të tilla rrethana, nga ana e Prokurorisë per Krime te Renda kane filluar veprimet hetimore ne lidhje me zbulimin, identifikimin, verifikimin e pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme, aktiviteteteve ekonomike të të ndjerit K. S. dhe personave te lidhur me te, (sipas neneve 3, 6, 8 dhe 9 te ligjit ne fjale).

Pas ketyre verifikimeve te perfaqesuesve te organit te akuzes, Prokuroria per Krime te Renda ka paraqitur ne gjykate nje kerkese per sekuestrimin e pasurive te te ndjerit K. S dhe familjareve te tij.

Nga ana e Gjykates per Krime te Renda Tirane me vendimin nr.5 date 26.02.2010 eshte vendosur sekuestrimi i ketyre pasurive:

- 1- Llogari bankare pranë Raiffeisen Bank, Durrës, me nr. xx xx xx xx xx, e celur në datën 01.10.2004 emër të shtetasit A. N. S, ne shumën 1 090 245 lekë, dhe me vlerë aktuale prej 1 226 518 lekë.**
- 2- Llogari bankare pranë Raiffeisen Bank, Durrës, me nr. xx xx xx xx xx, e celur në datën 01.10.2003 në emër të shtetases H. Xh. S, në shumën 420 000 lekë, dhe me vlerë aktuale 719 749 lekë.**
- 3- Pronë truall me sipërfaqe prej xxxx m2 ndodhur në zonën kadastrale nr. xxxx volumi x faqja xx, lagjen Rinia-Durrës, në pronësi të shtetasit A. N. S, blerë nga shtetasi H. I. M me kontratën nr. xx rep, xx kol datë 18.01.2005 për shumën 750 000 lekë dhe regjistruar në këtë Zyrë në datën 24.01.2005.**
- 4- Pronë truall me sipërfaqe xxxx mx, blerë nga shtetasi H. I. M. etj., me kontratën nr.xxxx rep., xxx kol. datë 26.06.2000 për shumën 800 000 lekë dhe regjistruar në këtë Zyrë në datën 27.06.2000, se bashku me ndërtesën Bar-Restorant prej xxx mx, e ndertuar mbi kete siperfaqje trualli, sipas lejës së ndërtimit nr. 4, datë 27.06.2000 të K RR T Bashkisë Durrës, të dyja në emër të shtetasit A. N. S., ndodhur në zonën kasatrale nr. xxxx, me nr. Pasurie x/xx, volumi x, faqja xx, ndodhur në lagjen Rinia, Durrës.**
- 5- Mjeti tipi Benz me targa xx xxxx x pronë e shtetasit A. N. S. blerë në datë 13.09.2002 nga shtetasi M. B.**
- 6- Mjeti tipi Ford me targa xx xxxx x pronë e shtetasit A. N. S. blerë në datë 05.07.2003.**

Pas perfundimit te “fazes se pare”,ate te sekuestrimit ne aplikim te ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimet te Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”.,Prokuroria per Krime te Renda Tirane I eshte drejtuar Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane me kerkesen per konfiskimin e ketyre pasurive.

Ne séance gjyqesore perfaqesuesi i akuzes paraqiti provat qe do ti nenshtroheshin shqyrtimit gjyqesore dhe konkretisht :

- Informacion lidhur me pasurite e te shtetasit K. N. S. dhe familjareve te tij, date 01/02/2010,**
- Vendim i datës 01/02/2010, per regjistrimin e procedimit pasuror,**
- Vendim i datës 03.04.2005, për regjistrimin e procedimit penal 35,**
- Vendim i datë 11.03.2005 për shpalljen e moskoptencës dhe kalimin e akteve Prokurorisë për Krime të Rënda,**
- Vendim i datës 09.03.2006 i Prokurorisë për Krime të Rënda për rifillimin e hetimeve të procedimit penal nr. 489 të vitit 1988 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë,**
- Vendim i datës 20.05.2007, për ndarjen nga procedimi penal nr. 35 të materialeve në lidhje me vrasjen e shtatsve K. S. dhe O. T. ,**
- Vendim i dates 09/03/2006 i Prokurorise per Krime te Renda Tirane, per rifillimin e hetimeve te procedimit penal nr.489 te vitit 1998 te Prokurorise se Rrethit Durres.**
- Kerkese e Prokurorise per Krime te Renda , e dates 16/06/2007 per Gjykimin e procedimit penal nr.35 te vitit 2005,**
- Vendim i dates 12.09.2006, për njoftimine akuzës së shtetasit E. D.**
- Vendim i datës 01.06.2007, për njoftimine akuzës së shtetasit I. T.**

- **Vendim i datës 12.09.2006, për njoftimin e akuzës së shtetasit L. B.**
- **Kërkesë datë 16.06.2007 për dërgiminnë gjyq të e çështjes nr. 35 të vitit 2005**
- **Informacion per referimin e vepres penale, i dates 28/02/2005,**
- **Procesverbali i kqyrjes se vendit te ngjarjes date 26/02/2005, se bashku me tabelen fotografike perkatese,**
- **Akti i ekspertimit mjeko-ligjor nr.07, date 26/02/2005.**
- **Çertifikata e vdekjes se K. S, me nr.155/0 leshuar ne date 22/02/2010, nga Lagja nr.15-Durres.**
- **Çertifikata Familjare e A. S, me nr.155/41 leshuar ne date 18/02/2010, nga Lagja nr.15-Durres.**
- **Çertifikata e trungut familjar e A. S, me nr.155/41 leshuar ne date 18/02/2010, nga Lagja nr.15-Durres.**
- **Shkresa nr. . 1065/1 datë 18.02.2010 e Bankës Raiffeisen Bank Dega Durrës lidhur me llogaritë bankare me bankare me xx xx xx xx xx, e celur në emër të shtetasit A. N. S dhe nr. xx xx xx xx xx, e celur në emër të shtetases H. Xh. S, së bashku me pasqyren perkatese te llogarise bankare,**
- **Vendimi per kryerjen e kqyrjes, date 19/02/2010**
- **Procesverbal për kqyrjen dhe marrjen e dokumentave i datës 23.02.2010 mbajtur në zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Palujtshme Durrës së bashku me aktet e ndodhura në këtë zyrë :**
 - **Aplikim, kërkesë regjistrimi dhe lëshimi çertifikatë kopje e Z.RR.P.P, Durres, e datë 19.01.2005 bërë nga shtetasi A. S**
 - **Kontratë shitblerje me nr. xx rep., xx kol datë 18.01.2005 me shitës H. I. M. dhe blerës A. N. S, para noteres A. H**
 - **Çertifikatë për vërtetim pronësie për pronën ndodhur në zonën kadastrale nr. xxxx vulomi x faqja xx e shtetasit H. I. M lëshuar në datën 17.01.2005**
 - **Kartela e pasurisë së palitshme të shtetasit H. M**
 - **Harta treguese e pasurisë së palujtshme të shtetasit H. M**
 - **Mandat arkëtimi i shtetasit H. M**
 - **Fletë regjistri e pasurisë së shtetasit A. S**

- Aplikim, kërkesë regjistrimi dhe lëshimi çertifikatë kopje datë 06.06.2001, bërë nga shtetasi A. S

-Vërtetim nga dokumenti hipotekor për pronën e shtetasit A. S ndodhur në zonën kadastrale nr. xxxx në Bisht-Pallë Durrës lëshuar në datën 28.06.2000

-Vërtetim Hipotekor datë 03.11.2995 për pronat e shtetasit E. M, H. M etj.

-Vendim i Komisionit të kthimit dhe kompesimit të pronave Durrës nr. 86 datë 14.10.1995

-Vërtetim nga dokumenti hipotekor për pronën e shtetasve E. M, H. M etj., ndodhur në zonën kadastrale nr. 3184 në Bisht-Pallë Durrës lëshuar në datën 26.06.2000

-Vërtetim nga dokumenti hipotekor për pronën e shtetasit A. N. S, ndodhur në zonën kadastrale nr. xxxx në Bisht-Pallë Durrës lëshuar në datën 28.06.2000

-Kontratë shit-blerje me nr. xxxx rep., xxx kol datë 26.06.2000 me shitës shtetaist, H. I. M, E. M. etj., dhe blerës A. N. S. , para noterit A. T.

-Prokurorë e posaçme me nr. xxxx rep dhe xxxx kol datë 18.11.1995 bërë para notërit A. T.

-Kartela e pasurisë së palitshme të shtetasit A. N. S. , për pronën ndodhur në zonën kasatrale nr. xxxx, me nr. Pasurie x/xx, volumi x, faqja xx, ndodhur në lagjen Rinia, Durrës

- Aplikim, kërkesë regjistrimi dhe lëshimi çertifikatë kopje datë 11.07.2002 bërë nga shtetasi A. S.

-Deklaratë noteriale e shtetasit A. S me nr. Rep 158 dhe kol 111, dt.07/02/2003, para noterit M .N

-Shkresë e Seksionit të Urbanistikës së Bashkisë Tiranë, me nr.40 prot, dt. 30/05/2002, dërguar ZRPP Durrës për regjistrimin e pronës së shtetasit A. S Bar-Restorant së bashku me gjithë dokumentacioni e lejës së ndërtimit, kolaudimit dhe lejës së shfrytëzimit të objektit gjithse 22 (njëzet e dy) fletë.

- Vendim per kqyrjen e dosjeve te mjeteve, date 19/02/2010,
- Procesverbal përe kqyrjen dhe marrjen e dokumentave i datës 22.02.2010 mbajtur në zyrën e Drejtorisë rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Durrës lidhur me mjete në pronësi të shtetasit

K. S etj., së bashku me aktet e ndodhura në këtë zyrë:

- **Dosja e targimit të mjetit me targa xx xxxx x në pronësi të shtetasit A. N .S gjithsej 19 (nëntëmbëshjetë) fletë.**
- **Dosja e targimit të mjetit me targa xx xxxx x në pronësi të shtetasit A. N. S. gjithse 18 (tetëmbëshjetë) fletë.**
- **Dosja e targimit të mjetit me targa xx xxxx x në pronësi të shtetasit A. N. S. gjithse 17 (shtatëmbëshjetë) fletë.**
- **Dosja e targimit të mjetit me targa xx xxxx x në pronësi të shtetasit K. A. S. gjithse 15 (pesëmbëshjetë) fletë.**
- **Si dhe në tërësi, aktet e fashikullit të procedimit penal dhe pasuror.**

Mbi bazen e provave te sipercituara Prokuroria per Krime te Renda Tirane ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor kerkoj pranimin e kerkeses per konfiskimin e pasurive 1. Pronë truall me sipërfaqe prej xxxx mx, 2.Pronë truall me sipërfaqe xxx mx, së bashku dhe me një objekt Bar-Restorant me sip.xxx mx, 3. Autoveture,me targa xx xxxx x, dhe 4.Autoveture me targa xx xxxx x, te gjitha keto prona te shtetasit A. N. S. , si prona qe jane krijuar nga aktiviteti kriminal i te ndjerit K. (K.) S. ,si dhe Heqjen dorë nga konfiskimi i pasurive 1.Depozitë kursimi në emër të shtetasit A. N. S. dhe Depozitë kursimi në emër të shtetases H. Xh. S. pasi keto pasuri krijuar me burime te ligjshme.

Mbrojtja e personave te trete A. dhe H. S. paraqiten prova,pasi sipas ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”., eshte detyrimi i tyre per te provuar ligjshmerine e te ardhurave te tyre,pra barra e proves i bie personave te trete sepse i padituri nga Prokuroria shtetasi K. (K.) S. aktualisht nuk jeton pasi eshte vrare me date 26/02/2005.

Përfaqësuesit e shtetasit K. S. dhe personave të tretë perpara gjykates kerkuan pushimin e gjykimit pasi sipas tyre i ndjeri K. (K.) S. eshte vrare me date 26/02/2005 dhe kerkesa per konfiskimin e pasurise eshte paraqitur ne sekretarine e gjykates me date 06.07.2010 dhe si e tille eshte jashte afatit x vjecar te percaktuar ne nenin 3/3 te nr.10192 dt. 03.12.2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”.

Ne lidhje me kete kerkese gjykata ne aplikim te nenit 3/3 te nr.10192 dt. 03.12.2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”,ku thuhet se:

“Masat parandaluese mune te kerkohen dhe ndaj trashegimtareve te personit,subjekt I ketij ligji,por,ne cdo rast,jo me vone se 5 vjet nga data e vdekjes.”,

Gjykata konstaton qe i ndjeri K. (K.) S. eshte vrare me date 26/02/2005,ndersa kerkesa e Prokurorise per Krime te Renda per sekuestrimin e pasurise ne aplikim te ligjit te sipercituar eshte paraqitur ne Gjykate me date 25.02.2010,pra pa u mbushur afati 5 vjecar I percaktuar ne ligj.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor nga ana e përfaqësuesit të shtetasit K. S. dhe personave të tretë me qëllim justifikimin e burimeve të pasurisë janë paraqitur para gjykatës provat shkresore të mëposhtme:

1-Shkresa nr.4816/1 datë 22.06.2010 e Drejtorisë së Shpronësimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, sipas së cilës me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 747 datë 26.11.1998 shtetases H. S. (person i tretë në këtë proces gjyqësor), i janë shpronësuar xxx mx sipërfaqe tokë bujqësore së bashku me prodhimet në vlerën 541 500 lekë, me qëllim ndertimin e superstrades Durrës - Sukth.

2-Shkresa nr. 1000 datë 04.02.2001 e Bankës Raiffesen, sipas së cilës shtetasit N. S. dhe H. S. kanë pasur depozitë kursimi dyemrore në lekë të çelur në datën 21.02.1997 në shumën 1 000 000 lek. Në datën 18.05.2001 shtetasi A. S. ka tërhequr nga llogaria e tij shumën e depozitës së bashku me interesat gjithsej 1 902 083 lek. Në po të njëjtën datë ka çelur një depozitë me afat 3 mujor në shumën 901 000 lek. Aktualisht gjendja e kësaj depozite është 1 226 629 lekë lekë. Kurse shtetasja H. S. ka një depozitë kursimi çelur në datën 01.10.1999 në shumën 420 000 lekë. Aktualisht kjo depozitë së bashku me interesat është 719 749 lekë.

Me provat e paraqitura ne gjykim,perfaqesuesi i personave te trete kerkoi rrezimin e kerkeses se organit te akuzes si te pambeshtetur ne prova,pasi:

1.Llogaria bankare prane Raiffeisen Bank,Durrës,me nr.xxxxxxxxxx, në emër të shtetasit A. N. S. eshte llogari e

krijuar nga viti 1996 dhe jane llogari te formuara nga puna e ndershme e shtetasve A. S. dhe H. S.

2.Llogaria bankare prane Raiffeisen Bank,Durrës,me nr.xxxxxxxxxx, në emër të shtetas H. Xh. S. eshte llogari e krijuar si rrjedhoje e shpronësimeve te nje toke qe H. S. e ka perfituar nga ish-Ndermarrja Bujqesore Shkozet Durres.

3.Ne lidhje lidhje me pronen truall me sipërfaqe prej xxxx mx eshte blere ne vitin 2000,

4.Pronë truall me sipërfaqe xxx mx, së bashku dhe me një objekt Bar-Restorant me sip.xxx mx, si dhe

5. Autoveture,me targa xx xxxx x, dhe 6.Autoveture me targa xx xxxx x, te gjitha keto prona jane blere me kontribut familjar te shtetasit A. S. dhe nuk kane asnje lidhje me aktivitetin kriminal te K. (K.) S.

Perfundimisht Gjykata,vlerësuar se pasuritë objekt kërkese për konfiskim janë në zotërim të personit të tretë A. N. S. (babai i personit të dyshuar të ndjerit K. S.), si dhe na rezulton e provuar se pasurite : 1. Pronë truall me sipërfaqe prej xxxx mx, 2.Pronë truall me sipërfaqe xxx mx, së bashku dhe me një objekt Bar-Restorant me sip.xxx mx, 3. Autoveture,me targa xx xxxx x, dhe 4.Autoveture me targa xx xxxx x, janë krijuar pas periudhës së përfshirjes së të ndjerit në aktivitet kriminal (pas datës 17/10/1998).

Ne gjykim pervec pasurive te quajtura “llogari bankare” me nr.xxxxxxxxxx dhe me nr.xxxxxxxxxx, në pronësi të shtetasve N. S. dhe H. S. te cilat vertetohen plotesisht qe janë krijuar nga burime të ligjshme,pasurite e tjera me provat e servirura ne gjykim nuk arriten te bindnin gjykatën per menyren e ligjshme te krijimit te tyre.

Duke vlerësuar se këto pasuri nuk kanë prejardhje të ligjshme,sepse në gjykimin me objekt konfiskimin e pasurive nuk u soll asnjë provë e cila të justifikonte ligjshmërinë e të ardhurave të këtyre pasurive dhe i përket personave të tretë që të justifikojnë ligjshmërinë e prejardhjes së pasurive, duke pasur parasysh faktin që Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda - Tiranë, me vendimin e saj nr.5, datë 26/02/2010, ndër të tjerat ka vendosur masën e sekuestros mbi pasuritë objekt gjykimi, si dhe nga

shqyrtimi gjyqësor na rezultoi se personi i tretë dhe personat e lidhur me të nuk kanë asnjë aktivitet apo të ardhura ligjore të provuara me dokumenta zyrtare, gjykata cmon te pranoje kerkesen e organit te akuzes per konfiskimin e tyre.

Gjykata vlereson te drejte qendrimin e mbajtur nga akuza per heqjen dorë nga konfiskimi i pasurive te quajtura “llogari bankare” me nr.xxxxxxxxxx dhe me nr.xxxxxxxxxx, pasi rezulton se vetëm keto llogari bankare në pronësi të shtetasve N. S. dhe H. S. janë krijuar nga burime të ligjshme pasi 1. llogaria bankare në shumën 1 226 629 lek rrjedh nga një llogari e çelur para muajit xxxxx xxxx kur është periudha e përfshirjes në aktivitet kriminal të të ndjerit K. (K.) S. ,dhe 2.llogaria bankare e shtetases H. S. në shumën 420000 lekë, ka burim të ligjshëm, pasi pavarësisht faktit së është çelur në vitin 1999 kjo shtetase shumën prej 541 500 lekë e ka përfituar nga shteti.

Në këto kushte,gjykata,për këto pasuri në aplikim dhe të nenit 24 të ligjit , nr.10192, datë 03/12/2009 cmon se ato nuk mund të konfiskohen,por duhet pushuar gjykim per kete pjese dhe te urdherohet heqja e sekuestros e vendosur me vendimin nr.5 dt.26.02.2010 mbi keto pasuri.

PER KETO ARSYE

Per sa me siper bazuar ne nenet; 21/2 dhe 24 e vijues të ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Per parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”;

V E N D O S I :

3- Pranimin e kerkeses.

I. Konfiskimin e pasurive të mëposhtme :

1. Pronë truall me sipërfaqe prej xxxx mx ndodhur në zonën kadastrale nr. xxxx, Pasuria me nr.x/xx, volumi, x faqja xx, e cila ndodhet në adresën Rinia-Durrës, në pronësi të shtetasit A. N. S. , blerë

nga shtetasi H. I. M. me kontratën nr. xx rep., xx kol datë 18.01.2005, për shumën 750 000 lekë dhe regjistruar në këtë Zyrë në datën 24.01.2005.

2. Pronë truall me sipërfaqe xxx mx, ndodhur në zonën kasatrale nr. xxxx, me nr. Pasurie x/xx, volumi x, faqja xx, me adrese Rinia-Durrës, blerë nga shtetasi H. I. M. etj., me kontratën nr. xxxx rep., xxx kol. datë 26.06.2000 për shumën 800 000 lekë, dhe regjistruar në këtë Zyrë në datën 27.06.2000, së bashku dhe me një objekt Bar-Restorant me sip. xxx mx, i cili është ndërtuar mbi këtë sipërfaqe toke, sipas lejes së ndërtimit nr. x, datë 22.06.2001 të K RR T Bashkisë Durrës, të dyja në emër të shtetasit A. N. S. ,

3. Autovetures tip Benz, me targa xx xxxx x, me nr. shaspie xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx pronë e shtetasit A. N. S. , blerë në datë 13.09.2002 nga shtetasi M. B..

4. Autovetures tip Transit, marka Ford me targa xx xxxx x, prodhim i vitit xxxx, me nr. shaspie xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx, pronë e shtetasit A. N. S. blerë në datë 05.07.2003.

II. Pushimin e gjykimit te kerkeses per konfiskimin e pasurive dhe heqjen e sekuestros te vendosur me vendimin nr.5 dt.26.02.2010 mbi pasurite e të mëposhtëme :

1. Depozitës së kursimit të Raiffeisen Bank, Durrës, me nr. xxxxxxxx, e çelur në datën 01.10.2004, në emër të shtetasit A. N. S. në shumën 1 090 245 lekë, dhe me vlerë aktuale x xxx xxx lekë, dhe

2. Depozitës së kursimit të Raiffeisen Bank - Durrës, me nr. xxxxxxxx, e çelur në datën 01.10.2003, në emër të shtetasit H. Xh. S. në shumën 420 000 lekë, dhe me vlerë aktuale 719 749 lekë.

III. Per Administrimin dhe perdorimin e ketyre pasurive te paluajtshme te ngarkohet zj.E. Ç. , ndersa per pasurite e luajtshme te ngarkohet z. I. D. , te cilet jane Administratore prane Agjencise per Administrimin e pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara prane Ministrise se Financave Tirane, ndersa per ekzekutimin e ketij vendimi te ngarkohen Zyra e Permbarimit e Rrethit Durrës.

4- Kunder vendimit lejohet ankim brenda 15 diteve ne Gjykatën e Apelit per Krime te Renda Tirane.

5- U shpall sot ne Tirane, me date 09.03.2011.

SEKRETARE

GJYQTAR

ANKELA DAKE

DRITAN HALLUNAJ